

Disa Mësime të Bukura të Islamit

Sot unë jam i udhëzuar të paraqes përpara jush disa nga mësime të mrekullueshme të Islamit. Unë u përpoqa të zgjedh vetëm ato mësime të Islamit, të cilat janë të veçanta dhe që fetë dhe sektet e tjera nuk i kanë. Edhe pse bëra këtë përzgjedhje, numri dhe sasia e madhe e bënë të vështirë për mua, që të zgjidhja pak prej tyre për t'i paraqitur në fjalimin e sotëm. Më ndihmoftë Allahu ta përmbush këtë detyrë në mënyrën më të mirë të mundshme. *Amin.*

Sipas Kuranit të Shenjtë, Islami është feja e fundit dhe përfundimtare. Në të gjithashtu janë të përmendura të gjitha mësime të nevojshme, të cilat nevojiten në ndonjë sferë të jetës së njeriut deri në Ditën e Gjykimit. Është shumë interesante të dimë se ky deklaram i madh edhe universal paraqitet vetëm nga Kurani i Shenjtë. Asnjë libër qiellor nuk ka një deklaram të tillë. Kurani i Shenjtë thotë:

“Sot e kam përsosur për ju fenë tuaj dhe e kam plotësuar ndaj jush favorin Tim, dhe pëlqeva që Islami të jetë feja juaj.”
(Sura 5 Al-Majdah Ajeti 4)

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, themeluesi i Bashkësisë Myslimane Ahmedia ka thënë:

Islami – Feja e Vërtetë

“Kjo do të thotë se Zoti kërkon prej nesh që të pajtohemi me atë që është e genësishme në fjalën Islam. Këtu është një deklaram e qartë se Kurani i Shenjtë përfshin mësime të përsosura dhe se koha e shpalljes së Kuranit të Shenjtë ishte koha kur mund të shpallehin këto mësime të përsosura. Vetëm Kurani i Shenjtë e bën një deklaram të tillë. Asnjë libër qiellor nuk ka një deklaram të tillë.”

[Brahin-e-Ahmadiyya, Pjesa V, Ruhani Khaza'in, Vol. 21, faqe. 3]

Përpara se të vazhdojmë më lejoni t'ju paraqes një skemë të shkurtër të bazamentit të mësimeve Islamike me fjalët e Profetit të shenjtë ^{s.a.s.}

*“Një ditë Pejgamberi ^{s.a.v.s} doli në mesin e njerëzve; iu afrua atij një njeri dhe e pyeti:
“Çka është besimi?”*

“Besimi është të besosh Allahun, Engjëjt e Tij, takimin me Të, të besosh gjithë Pejgamberet e Tij dhe Ringjalljen.” u përgjigj Pejgamberi ^{s.a.v.s}.

“Po çka është Islami?” Pyeti ai.

Profeti ^{s.a.v} u përgjigj: “Islami është ta adhurosh vetëm Allahun, të mos i përshkruash shok Atij, të falësh namazin, të japësh Zekatin dhe të agjërosh Ramazanin”

“Po çka është mirësia?” pyeti ai.

Pejgamberi ^{s.a.v} u përgjigj: “Ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë. Nëse ti nuk e sheh Atë, Ai, pa dyshim, të sheh ty.”

(Sahihul Bukhari Libri i Besimit, Nr. Hadithit 50)

Dëgjues të nderuar! Besimi themelor i Islamit është Njëshmëria e Zotit dhe besimi i të gjithë myslimanëve është – ‘*La ilaha illallah*’ – Nuk ka Zot përveç Allahut. Kjo Njëshmëri e Zotit është Shtylla e parë dhe më kryesore e mësimëve islamike dhe çdo besim tjetër dhe mësimet e tij varen pikërisht në këtë shtyllë. Islami e mohon kategorikisht shoqërimin e ndonjë gruaje, biri apo ndihmësi me Të. Kurani i Shenjtë thotë:

“Allahu është Një. Allahu është Ai që çdo krijesë varet prej Tij dhe Ai është i pavarur. Ai nuk ka lindur askënd e as nuk është i lindur. Dhe askush nuk i përngjet Atij.”

(Sura 112 Al-Ikhlâs; Ajetet 2-5)

Qëllimi kryesor i të gjitha shpalljeve është që të theksojë konceptin e Njëshmërisë së Zotit, të theksojë se i gjithë admirimi, lavdërimi, adhurimi dhe bindja i perkasin vetëm Atij. Ai është synimi i dashurisë dhe devotshmërisë më të thellë të zemrës. Të kërkosh afërsinë me Të, të veprosh sipas Vullnetit të Tij në të gjitha aspektet, të fitosh kënaqësinë e Tij, të shndërrohesh në shfaqjen e cilësive të Tij, është si të thuash, në imazhin e Tij, ky është qëllimi i krijimit të njeriut. (51:57). Përveç konceptit të Njëshmërisë së vërtetë të Zotit të Plotfuqishëm, ka edhe një ndryshim midis mësimëve islamike dhe jo islamike të ditëve të sotme. Pothuajse të gjitha fetë deklarojnë se Zoti nuk komunikon sot me shërbëtorët e Tij. E vetmja gjë që ka mbetur është kënaqësia shpirtërore. Por sipas Islamit, në mënyrë të veçantë sipas kuptimit të Bashkësisë Myslimane Ahmedia, Zoti ynë mund të komunikojë akoma me ata që do Ai. Unë dëshiroj të citoj disa fragmente nga shkrimet e themeluesit të Bashkësisë Myslimane Ahmedia, Hazret Mirza Ghulam Ahmed sahib ^{a.s.} të cilat në mënyrë shumë të bukur paraqesin konceptin e kuptimit të Zotit nga ai. Ai thotë:

“Dëgjoni! Atë çfarë Allahu e dëshiron nga ju? Gjithçka që Ai dëshiron nga ju është që ju të bëheni të Tij. Mos i bëni shok Atij asgjë tokësore e qiellore. Zoti ynë është Ai i Cili jeton sot sikur që ka jetuar përpara. Ai flet sot sikur që ka folur përpara dhe Ai dëgjon sot sikur që ka dëgjuar përpara. Është budallallëk që të mendohet se Allahu dëgjon por nuk flet më. E vërteta është se Allahu dëgjon dhe flet. Të gjitha vetit (atributet) e Tij janë të pavdekshme – pa fillim dhe pa mbarim. Asnjë nga vetit (atributet) e Allahut nuk i ka kaluar afati dhe kurrë nuk do të ju kalojë. Ai është i Vetmi pa shok: Ai nuk ka bir dhe nuk ka grua. Ai është i Pashoq; askush nuk është si Ai. Nuk ka kush që mund të ketë vetit (atributet) e Tij unike dhe nuk ka kush që është baras me Të. Nuk ka kush si Ai në vetit (atributet) e Tij dhe Fuqia e Tij kurrë nuk zvogëlohet. Ai është afër, por prapë Ai është larg. Ai është larg por prapë Ai është afër.

Atyre që u është dhuruar komunikimi i Shenjtë, Allahu e manifeston Vetën e Tij në një formë të përafërt me të Tij, por Ai nuk ka trup dhe nuk ka formë. Ai qëndron mbi të gjithë, prapë se prapë nuk mund të thuhet se dikush tjetër është nën Të. Ai është në qiej, por nuk mund të thuhet se Ai nuk është në tokë. Ai është përmbledhja e përsosur e të gjithatributeve dhe Ai është manifestim i gjithçkaje që është e çmueshme....

Asgjë nuk mund të bëhet pa Të. Ai e manifeston Vetën e Tij përmes Madhësisë, Fuqisë, dhe Shenjave të Tij. Përmes tyre ne mund ta arrijmë Atë. Allahu gjithmonë e manifeston Vetën e Tij tek njerëzit e devotshëm dhe Ai ju tregon atyre Fuqinë e Tij. Kështu ne mund ta njohim dhe mund ta identifikojmë rrugët që janë të preferuara nga Ai. Allahu sheh pa sy fizikë, Ai dëgjon pa vesh fizikë dhe flet pa gjuhë fizike.” (Alvasijjat)

Një nga çështjet më kryesore të botës së sotme është paqja dhe harmonia ndërjetare. Ndjekësit e çdo feje deklarojnë se vetëm ata janë në udhë të drejtë në këtë botë dhe se vetëm ata do të bëhen trashëgimtarët e Parajsës në botën tjetër dhe se pjesa tjetër janë në rrugë të gabuar. Fatkeqësisht, ky mendim në ditët e sotme po krijon një ç’rregullim të madh anë e mbanë botës. Përpara një skenari të tillë, nëse mendoni që të gjeni mësimet më të mira që mund të eliminojnë këtë çrregullim, ju mund t’i gjeni ato vetëm në Islam.

Islami është e vetmja fe në botë, e cila me mësimet e saj të mrekullueshme paraqet zgjidhjen hyjnore për të shpëtuar nga keqkuptimet dhe tensionet e thella të zhvilluara midis feve.

Së pari, Ajo deklaron se të gjitha fetë dhe reformatorët e tyre të Shenjtë janë të vërtetë dhe janë nga i njëjti burim, i cili është Allahu i Plotfuqishëm. Në Kuranin e Shenjtë thuhet:

“Dhe Ne kemi dërguar te secili popull një profet me këtë mësim: O njerëz, adhurojeni vetëm Allahun dhe shmanguni prej çdo njeriu rebel. Atëherë, disa prej tyre vepruan aq mirë sa që Allahu i përdudhi ata, por disa prej tyre janë bërë pre e shkatërrimit. Pra, udhëtoni nëpër tokë dhe shihni se si ishte përfundimi i atyre që i përgënjeshtroan (profetët)!” (Sura 16 Al-Nahl; Ajeti 37)

Mendoni për një moment mbi universalizimin e këtij mësimi, i cili paraqitet vetëm nga Islami, siç thotë Kurani i Shenjtë:

“Vërtet, ata të cilët e mohojnë Allahun dhe Profetët e Tij dhe dëshirojnë të krijojnë dallim midis Allahut e profetëve të Tij dhe thonë: Ne i besojmë disa (profetë), kurse disa të tjerë i mohojmë, dhe (ata) dëshirojnë që të marrin ndonjë qëndrim ndërmjet këtyre, Të tillat janë mosbesimtarë të vërtetë, ...”

(Pastaj Allahu i Lartësuar thotë)

“Ndërsa ata të cilët e besojnë Allahun dhe profetët e Tij dhe që nuk bëjnë ndonjë dallim midis asnjërit prej tyre (profetëve), të tillëve së shpejti Allahu do t’u japë shpërblimet e tyre. Dhe Allahu fal shumë dhe është i Mëshirshëm.” (Sure 4 AN-Nisa: Ajetet 151-153)

Por siç e përmenda më parë, të gjithë njerëzit që i përkasin ndonjë feje të ndryshme nga Islami, deklarojnë se vetëm feja e tyre është e vërtetë dhe se të tjerat janë vetëm mashtrime. Për shembull, një i krishterë nuk mund të mbetet një krishterë nëse ai thotë se qoftë edhe një profet i cili ka ardhur jashtë izraelitëve është i vërtetë. Në mënyrë të ngjashme një budist nuk mund të pranojë vërtetësinë e ndonjë profeti i cili deklarohet si profet nga Bibla ose nga Kurani i Shenjtë. Një hebreu gjithashtu i duhet të mohojë të gjithë profetët të cilët nuk janë nga Izraelitët, përfshirë këtu edhe Jezusin dhe Profetin e shenjtë^{s.a.s}. Një hindu mund t’i mbetet besnik besimit të tij vetëm nëse ai beson se vetëm Vedat e Hinduve, që janë mijëra vjeçare, janë të vërteta. Madje nëse ai do të mendojë se mbase Kurani i Shenjtë, Bibla dhe ndonjë libër i shenjtë vjen nga Zoti i Plotfuqishëm, ai nuk do të ishte një

hindu i sinqertë. Kjo vjen si rezultat i faktit së të gjithë besimtarët e feve që përmendem, besojnë se shpalljet nga Zoti i Plotfuqishëm kanë përfunduar me ardhjen e Profetëve të feve të tyre.

Por për t'u bërë një mysliman, sipas Kuranit të Shenjtë, një nga shtyllat bazë është që të besosh mbi vërtetësinë e të gjithë profetëve. Kur një hindu kthehet në mysliman ai nuk duhet të mohojë të vërtetën e profetëve të tij të dashur të cilët erdhën në hinduizëm, por ai duhet vetëm të riparojë besimin e tij mbi ta; që do të thotë se ai duhet të besojë se ata nuk ishin Zota, por ishin profetë dhe njerëz të devotshëm dhe të përvuilur dhe shërbëtorë të Zotit. Në të njëjtën mënyrë, ndonjë besimtar që do të pranojë Islamin, atij i duhet thjesht të reformojë besimin e tij mbi profetët dhe fenë e tij.

Dëgjues të nderuar! Unë dua t'ju tërheq vëmendjen tuaj në çështjen që vetëm mësimet e mrekullueshme të Islamit rreth universalizimit të profetizmit mund të sjellin paqe mes të gjitha feve. Kalifi i Katërt i Komunitetit Mysliman Ahmedia, Hazreti Mirza Tahir Ahmed Sahib ^{r.a}. ka thënë:

“Unë besoj se për një fe që të jetë e dobishme në vendosjen e paqes në botë, është themelore që një fe që është e aftë të bashkojë njerëzit në mënyrë përfundimtare, duhet në vetvete të pranojë universalitetin e fesë në kuptimin që qeniet njerëzore, cilado qoftë ngjyra, raca apo përkatësia gjeografike e tyre, janë të gjitha krijesa të të njëjtit Krijues. Si të tilla, ato janë të barabarta që të marrin udhëzime hyjnore – nëse udhëzimet hyjnore u janë dhënë ndonjëherë ndonjë pjese të shoqërisë. Kjo pikëpamje shmang konceptin e monopolizimit të së vërtetës nga ndonjë fe.”

(Përgjigjet e Islamit ndaj Çështjeve Bashkëkohore, faqe 18, 19)

Islami jo vetëm që deklaron vërtetësinë e të gjithë profetëve, por gjithashtu thotë se askush nuk duhet të ketë të drejtën të ndryshojë fenë e dikujt me forcë, meqë është një çështje e ndjenjave dhe besimit personal. Madje edhe një person që nuk beson në ndonjë fe mund të mbështesë këtë mënyrë të menduarit. Kurani i Shenjtë thotë:

“Nuk ka dhunë në çështjen e fesë. (Sepse) pa dyshim, e vërteta është dalluar nga e pavërteta.” (Sura 2 Al-Bakara Ajet:256)

Duke iu drejtuar Hazret Muhamedit ^{s.a.s.} Kurani i Shenjtë thotë:

“Ti vetëm këshillo se je vetëm një këshillues. Ti nuk je caktuar mbikëqyrës për ta.” (Sura 88 Al-Ghashia Ajetet 22 dhe 23)

Dhe ai thotë:

“Por, nëse ata, (d.m.th. jo myslimanët) megjithëkëtë, shmangen, atëherë ta dish se Ne nuk të kemi dërguar ty mbikëqyrës të tyre. Detyra jote është vetë t’ua përcjellësh mesazhin (Tonë). (Sura 42 Ash-Shura Ajet 49)

Kështu që e parë nga çdo aspekt, paqja dhe harmonia ndërfitare në botë mund të arrihet vetëm me mësimet e mrekullueshme të Islamit. Për më tepër këto mësimet, në vetvete e paraqesin Islamin si e vetmja fe universale.

Tani le të hidhemi në temën e paqes në botë. Në fushën e paqes Ndërkombëtare, feja dhe paqja ndërkombëtare e fetare zë një vend shumë të rëndësishëm. Në këtë fushë Islami gjithashtu jep mësimet më të mira të mundshme për ndjekësit e tij për të krijuar një atmosferë me paqe anë e mbanë botës. Është vërtetë befasuese të shikosh shumë dijetar myslimanë me mentalitet mesjetar të pajtohen me idenë se myslimanët duhet t’i kundërvihen jo myslimanëve në një luftë me armë dhe të qëndrojnë në luftë me ta, derisa ata të jenë shfarosur ose të kenë pranuar Islamin. Islami, siç gjendet në Kuranin e Shenjtë, nuk ka të bëjë fare me këto nocione të shtrembëruara dhe të deformuara të Xhihadit. Përkundrazi Islami kërkon të shpërndajë paqen me të gjitha mënyrat.

Kurani i Shenjtë fillon me këto vargje:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

Alhamdulillah Rabbil Aalameen.

Do të thotë se Zoti që Islami na paraqet nuk është vetëm Zoti i Lindjes apo Perëndimit, i ndonjë kaste apo i ndonjë vendi në veçanti, por Ai është Zot i të gjithë botëve dhe i mëshiron të gjitha ato. Dhe Islami është e vetmja fe, ku vetë Zoti e ka emërtuar si **ISLAM**, që do të thotë të japësh siguri. Dhe ai që ndjek këtë fe, që sjell siguri, quhet mysliman, që do të thotë, ai që jep siguri. Të praktikosh të gjitha rregullat dhe udhëzimet quhet *Iman*, që do të thotë të përhapësh paqen. Dhe personi që e pranon këtë *Iman* quhet *Momin*, që do të thotë, ai që përhap paqen nëpër botë me të gjitha mundësitë e tij. Dhe jo vetëm kaq, por Zoti që paraqet Islami ka shumë emra të bukur dhe njëri prej tyre është *Al-Selam*, që do të thotë, paqe e plotë. Edhe themeluesit të Islamit i është dhënë emri *Rahmat-ul-Lil-Alemin*, që do të thotë se ai është mëshirë për të gjithë Universin.

Dhe kundërshtarët e tij për para se të deklarohesh profet nga Zoti, e thërrisnin me titullin *Al-Amin*, që do të thotë, i kujdesshëm ndaj amaneteve dhe shpërndarës i paqes. Dhe engjëlli që i sillte shpalljet Profetit të shenjtë ^{s.a.s}.

quhet *Ruh-ul-Amin*, që do të thotë gjithashtu, shpirti i paqes. Dhe Allahu, i Plotfuqishmi përmes Islamit na dha një mësim të bukur që edhe kur të përshëndetemi me njëri-tjetrin duhet të themi:

Essalamo Alaikum Va rahmatullah Va Barakatuhu,

që do të thotë, *Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ty*. Allahu rreth kësaj përshëndetje në Kuranin e Shenjtë thotë:

“... kjo (përshëndetje) nga Zoti juaj është një lutje bekimdhënëse dhe e pastër...” (Kurani i Shenjtë An-Nur 62)

Në mësimet islamike, përveç këtij inkurajimi të madh për të vendosur paqen në botë, gjithashtu në Kuranin e Shenjtë mund të gjendet në mënyrë të përsëritur ky mësim i detyruar i cili urdhëron që të qëndrojmë larg të gjitha llojeve të çrregullimeve.

“Dhe sillu mirë ndaj të tjerëve ashtu siç u soll mirë Zoti ndaj teje, dhe mos dëshiro çrregullim nëpër tokë. Vërtet, Allahu nuk i do ata që krijojnë çrregullime.” (Sura 28 Al-Kasës; Ajeti 78)

Disa tipare dalluese të Islamit

Tema e tipareve dalluese të Islamit, është një temë shumë e gjerë dhe unë kam trajtuar vetëm pak aspekte që unë i zgjedha për këtë paraqitje. Koha nuk na lejon t’i trajtojmë gjerësisht ato kështu që unë po përmend thjesht si referenca kalimtare:

1. Islami nuk bën deklaratatë të kota dhe as na detyron ne të besojmë atë që ne nuk e kuptojmë. Ai i mbështet mësimet e tij me arsye dhe shpjegime, duke e kënaqur intelektin tonë dhe thellësinë e shpirtit tanë gjithashtu. Kurani deklaron se është mësimi më i mirë – një deklaram që nuk është bërë në asnjë libër tjetër që është shpallur.
2. Kurani deklaron se kombinon tiparet më të mira të skripteve më të hershme dhe se të gjitha mësimet e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse janë në të. Kurani thotë:

Ka mësimet e predikime të përhershme e të qëndrueshme. Dhe thotë: Kështu është shkruar në Skriptet e mëparshme. Në Skriptet e Ibrahimit e të Musait.

3. Një tipar tjetër dallues i islamit është se Profeti i tij kaloi çdo fazë të imagjinueshme të jetës, duke e nisur nga një fëmijëri e varfër dhe jetim dhe duke përfunduar në udhëheqës të padiskutueshëm të njerëzve të tij. Jeta e tij është dokumentuar deri në hollësi dhe pasqyron një besim të pakrahasueshëm ndaj Zotit dhe sakrifica të vazhdueshme në rrugën e Tij. Ai ka pasur një jetë të plotë e të mbushur me ngjarje me aktivitete dhe ka lënë pas një shembull të përsosur të sjelljes në çdo sferë të përpjekjeve njerëzore. Ai ishte një interpretim i gjallë i Kuranit dhe me shembullin e tij personal ndriçoi rrugën e njerëzimit për të gjitha kohërat që do të vijnë. Asnjë profet tjetër nuk e ka përmbushur një rol të tillë.
4. Islami deklaroi një barazi të plotë të njerëzve, pa dallim race, feje dhe ngjyre. I vetmi kriter nderi që vendos Islami është devotshmëria dhe jo ato të trashëguara nga lindja, pasuria, raca apo ngjyra. Kurani i Shenjtë thotë:

“Vërtet, më i ndershmi prej jush në sy të Allahut është ai i cili është më i devotshëm.” (Sura 49 Al-Huxhurat

Madje thotë:

“Kush bën ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, dhe është besimtar, këta do të hynë në parajsë, ku do të shpërblehen pamasë.” (Sura 40 Al-Momin Ajeti 41)

Tani koha nuk më lejon më që të vazhdoj të paraqes mësimet e mrekullueshme të Islamit. Shkurt, unë përsëri do të doja të tërhiqja vëmendjen tuaj se qëllimi kryesor i të gjitha këtyre mësimëve të mrekullueshme është që, duke vepruar sipas tyre, të arrijmë qëllimin e krijimit të njeriut, i cili është që të shikojë Fytyrën e atij Zoti të aq shumë dashur dhe të komunikojë me Të. Vërtet, për dikë që e di shijen e këtij fenomeni, ai do të përpiqet patjetër ta arrijë këtë madje edhe me kushtin që të humbasë gjithçka.

Tani do ta mbyll fjalimin tim me një citim tjetër nga shkrimet e Themeluesit të Lëvizjes Ahmedia, që është një thirrje për të gjithë njerëzimin:

“Pasqyra që bën të mundur ty të shikosh Atë Qenie të ngritur është lidhja shpirtërore e Tij me njeriun. Le të bëjë përpara ai që e ka zemrën të etur për të vërtetën dhe të kërkojë. Jua them unë shumë sinqerisht se nëse shpirtat kërkojnë ndershmërisht dhe zemrat janë

vërtet të etura për të vërtetën, atëherë njeriu duhet të kërkojë për metodën e duhur dhe rrugën e drejtë. Por si do të hapet kjo dhe si do të ngrihet kjo vello? Unë i siguroj të gjithë kërkuessit se vetëm Islami e jep lajmin e gëzuar të kësaj rruge, sepse të tjerët kanë kohë që e kanë mbyllur shpalljen e Zotit. Por të jini të sigurt se Zoti nuk e ka vendosur këtë vulë: ky është vetëm një justifikim i nxjerrë nga njeriu në humbjen e tij.

*Ashtu sikurse është e pamundur të shikojmë pa sytë tanë ose të dëgjojmë pa veshët tanë, pikërisht në të njëjtën mënyrë, është e pamundur të shikojmë fytyrën e Zotit tonë të dashur, pa ndihmën e Kuranit. Unë kam qenë i ri dhe tani jam plakur, por unë nuk kam parë kurrë askënd që të pijë nga **eliksiri** shpirtëror përfundimtar, përveç se nga ky burim i shenjtë.*

(Filozofia e Mësimeve Islame faqe 131, 132)

Pa dyshim, kjo thirrje është një mesazh jetëdhënës për çdo shpirt që kërkon të vërtetën.

Fjalimi i Xhelsa Salanës së Shqipërisë 20 Maj 2007.

Nga: Samad Ahmad Ghouri,

Misionari i Xhematit Mysliman Ahmedia të Shqipërisë